



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.980/22

GJYKATA KOMERCIALE -Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Ramush Bardiqi, kryetar, Krenar Berisha dhe Dren Rogova, anëtar, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit Ipko Telecommunications LLC me seli në Prishtinë kundër të paditurës komuna e Hanit te Elezit me adrese Hani i Elezit duke vendosur sipas ankesës së palës paditëse për anulimin e vendimit Nr. 10/nr. 9000/2018 i datës 09.11.2018, me bazë juridike: anulim i vendimit, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti Administrativ, Divizioni fiskal, A.nr.2851/18, të datës 22.06.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 21.06.2023, merr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET si e bazuar ankesa e të paditësit: Ipko Telecommunications LLC me seli në Prishtinë, NDRYSHOHET Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti Administrativ, Divizioni fiskal, Nr. A.nr.2851/18, të datës 22.06.2021, dhe çështja lëndore gjykohet si ne vijim:
- II. APROVOHET kërkesëpadia e paditësit Ipko Telecommunications LLC me seli në Prishtinë. ANULOHET aktvendimi Nr. 10/nr. 9000/2018 i datës 09.11.2018 i Komunës së Hani i Elezit-Komisionit i Ankesave.
- III. Obligohet Komuna e Hanit te Elezit, qe paditësin Ipko Telecommunications LLC me seli në Prishtinë, ta liroj nga borxhi i taksës-tatimit ne vlere prej 1000€ për periudhën 2018 përfshire kamatën dhe ndëshkimet, e caktuar me vendimin nr.10/nr.8606/2018 i dt. 12.10.2018.
- IV. Pika III (tre) e aktgjykimi të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti Administrativ, Divizioni fiskal, Nr. A.nr.2851/18, të datës 22.06.2021, mbetet e pashqyrtuar.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e ankimuar të gjykatës shkallës së parë, është refuzuar si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit Ipko Telecommunications LLC me seli në Prishtinë, dhe ka mbet ne fuqi vendimi i te paditurës.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë ka ushtruar paditësi, me të cilin e konteston ligjshmërinë e tij, për shkak të: shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Tutje deklaroi se aktgjykimi i atakuar është përfshi ne shkelje thelbësore te LKA-se neni 43 parag. 1 pasi vendimi është nxjerr ne kundërshtim me dispozitat e nenit 47 dhe 48 dhe neni 134 parag 1 te LPPA nr. 05/L-031 dhe ne kundërshtim e nenit 21 dhe 22 parag. 6 te Ligjit për Komunikim Elektronikë dhe Postar, neni 8 te Ligjit për financa e pushtetit lokal e cila dispozite nuk parasheh asnjë ngarkese për vendosjen e objekteve te telekomunikimit, si dhe ne kundërshtim me nenin 16 shtojca 1 parag. 1 nenparagrafi 1,16 ne te cilën objektet e telekomunikacionit klasifikohen ne kategorinë e II te ndërtimeve. Ne kundërshtim me nenin 10 dhe 14 të Ligjit për Financa e Pushtetit Lokal. Andaj ka propozuar që të aprovohet në tërësi si e bazuar ankesa e paditësit Ipko Telecommunications LLC me seli në Prishtinë, të ndryshoj Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti Administrativ, Divizioni fiskal, A.nr.2851/18, të datës 22.06.2021 apo te njëjtin te anuloi dhe çështja ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, vlerësoi ligjshmërinë e aktgjykimit të kontestuar si në vështrim të nenit 49 të LKA, neni 81.h të Ligjit për Ndryshimet dhe Plotësimet e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurën nr.03/L-222, dhe neni 194 i LPK-së, ligj i zbatueshëm sipas nenit 63 të LKA në drejtim të theksimeve në ankesë dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave tjera të lëndës gjjen se:

Ankesa është e **bazuar**.

Nga shkresat e lëndës rezulton së se e paditura me aktvendimin e caktuar me vendimin nr.10/nr.8606/2018 i dt. 12.10.2018 ka caktuar taksen per paditësin per lejimin e vendosjes se dy antenave- zona kadastrale Pusnikë me nr. Parcele 1334-1 ne shumë 500€ dhe tjera ne zonën kadastrale Dimce me nr. parcela . 418-0 ne shume 500€ ne total ne shume prej 1000€, paditësi- ankuesi ka parashtruar ankesa ne me Komisionin e Ankesave te Komunës e Hanit te Elezit për arsye se, në baze të Ligjit për Komunikimi Elektronike dhe Postare te nenit 22 paragrafi 6 liron rrjetat dhe facilitetet shoqëruese të komunikimeve elektronike nga taksa e pronës së paluajtshme. E paditura me aktvendimin Nr. 10/nr. 9000/2018 i datës 09.11.2018 i Komunës së Hani i Elezit-Komisionit i Ankesave ka refuzuar ankesën e paditësit për caktimin e taksës vjetore për ushtrim te veprimtarisë nga shkak se komisioni ka konstatuar se kjo është e përcaktuar me rregulloren për pagesën e taksave tarifave dhe gjobe komunale 31/ nr. 6566/2018.

Paditësi ka paraqitur padi me te cilën ka kontestuar vendimin e të paditurës me të cilin ngarkon paditësin pagesën ne shume totale prej 1000€ për dhënien e pëlqimit për vendosjen e dy antenave është i kundërligjshëm sepse ky vendim është nxjerr në kundërshtim me dispozitën e nenit 22 paragrafi 6 të LKE kjo për faktin se bazuar me këtë dispozitë ligjore është përcaktuar se pajisjet elektronike nuk i nënshtroheshin tatimit në prone. Përveç të metave në procedurën administrative, vendimi i atakuar gjithashtu ka të meta sepse nuk ka trajtuar të drejtën materiale nga Ligji i veçante me nr. 04/L-109 i cili në mënyrë shprehimorë përmes nenit 22 paragrafi 6 liron rrjetat dhe facilitetet shoqëruese të komunikimeve elektronike nga taksa e pronës së paluajtshme. Tutje deklaron se vendimi është nxjerr ne kundërshtim me dispozitat e nenit 47 dhe 48 dhe nenit 134 parag 1 te LPPA nr. 05/L-031 dhe aq me tepër bazohet ne Ligjin nr. 02/L-28 i cili ligji nuk është ne fuqi dhe po ashtu arsytimi i vendimit nuk i ka trajtuar te gjitha pretendimet ankimore te paditësit. Këshilla juridike e dhene afat prej 15 dite është ne kundërshtim me dispozitat e LKA-se. Vendimi i kontestuar është bazuar ne një vendim te mëhershme. E paditura me caktimin e taksës prej 1000€ ne mënyrë të tërthorte është duke aplikuar tatimin ne prone ndaj rrjetit te paditësit ne kundërshtim e nenit 22 parag 6 te ligjit për komunikim elektronikë dhe postar dhe meqenëse antenat janë te vendosura ne prona private dhe paditësi paguan qira ndërsa pronaret paguajnë tatimin ne prone për këto parcela lenë te kuptohet se taksa e vendosur nga paditësi paraqet takse te dyfishtë, dhe një taksë e tille do te aplikohet ne periudhë vjetore kur dihet se pagesa për leje duhet te jete pagese e njëhershme dhe jo e përsëritur për do vit. Caktimi i taksës bazohet nenit 8 te Ligjit për Financa e Pushtetit Lokal e cila dispozite nuk parasheh asnjë ngarkese për vendosjen e objekteve te telekomunikimt. Pagesa e taksës për ndërtim është kompetencë e Ministrisë se Mjedisit ne baze te nenit 16 shtojca 1 parag. 1 nenparagrafi 1,16 ne te cilën objektet e telekomunikacionit klasifikohen ne kategorinë e II te ndërtimeve.

E paditura ne përgjigje ne padi ka deklaruar se subjektin afarist ne komunën e Hanit te Elezit ushtron veprimtari te biznesit dhe ka vendosur antena te cilat përçojnë vale e te cilat patjetër se duhet llogaritur si veprimtari ne baze te kësaj komuna ne baze te Ligjit për Financa Pushtetit lokal nr. 03/L-049, nenit 10 parag 10.2 ka vendos për subjektin afarist takse për ushtrimin e veprimtarisë afariste, e cila takes është vjetore. Dhe ne përfundim kishte propozuar gjykatës qe te hedhet poshtë padinë e paditësit.

Gjykata Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, në këtë çështje juridike administrative të paditësit, mban seancë të shqyrtimit kryesor me datë 22.06.2021, në prani të përfaqësuesve të palëve ndërgjyqëse dhe pas administrimit të provave, bien aktgjykimin e ankimuar me të cilin, është refuzuar si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit Ipko Telecommunications LLC me seli në Prishtinë, dhe ka mbet ene fuqi vendimi i te paditurës, për arsye se, vendimi kontestuese nuk është përfshi ne shkelje te nenit 47 dhe 48 te LPPA, dhe vendimi është bazuar ne rregulloren e taksave dhe tarifave dhe gjoba nr. 01 nr. 6566/2018 i komunës e Hanit te Elezit.

Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, nisur nga kjo gjendje e çështjes, vlerëson se përfundimi dhe qëndrimi i gjykatës shkalles se pare rreth mënyrës se vendosjes nuk është i drejte dhe i ligjshëm, pasi qe aktgjykimi i atakuar është përfshirë me shkelje të dispozitave të Ligjit për Konfliktin administrative nenit 43 dhe 44 si dhe ne shkelje te nenit 183 parag 1 dhe 2 te LPK-se, si dhe aktgjykimin e atakuar ka pasur zbatimin e gabuar të së drejtës materiale, pasi qe gjykata ankimore ka qëndrim tjetër juridik lidhur me interpretimin e normës juridike ne raport me gjykatën e shkalles e pare, mbi bazën e së cilës gjendje faktike, kjo gjykatë vjen në përfundim se kërkesëpadia e paditëses del të jetë e bazuar, me çka në rastin konkret ka kushte qe aktgjykimi i atakuar të ndryshohet, ku edhe u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimit.

Kolegji i kësaj gjykate ka shqyrtuar pretendimet ankimore te paditësit dhe ka gjetur se aktgjykimi i atakuar është përfshi ne shkelje te dispozitave ligjor te nenit 44 te LKA-se i cili parasheh se “Për nulitetin e aktit administrativ gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare” kolegji i kësaj gjykate nuk pajtohet me qëndrimin juridik te gjykatës se shkalles se pare kur ka konstatuar se vendimi kontestues nuk është përfshirë ne shkeljet formale juridike te nenit 47 dhe 48 te LPPA-se, për arsye se, pas ekzaminim te vendimit kontestues ne drejtim te pretendimeve ankimore, kolegji ka gjetur se vendimi kontestues është përfshire ne shkelje te dispozitave te LPPA-se nenit 47 dhe 48 dhe LKA-se, pasi qe ne këshillë juridike është dhënë afati prej 15 dite e sipas ligjit duhet te jete 30 dite. Vendimi është bazuar ne ligjin nr. 02/L-28 te LPPA i cili ligji nuk ka qen ne fuqi ne kohen e nxjerrjes vendimit kontestues, pasi është shfuqizuar me Ligjin 05/L-031 te LPPA-se. *Neni 47 i LPPA-se parasheh se Struktura dhe elementet e detyrueshme të aktit administrativ të shkruar, akti administrativ përveç tjerash duhet te përmbaje:” pjesën përmblylëse, që tregon kohën e hyrjes në fuqi të aktit, informatat për mjetet juridike, përfshirë organin publik apo gjykatën ku paraqitet mjeti juridik administrativ apo gjyqësor, formën e mjetit, afatin përkatës dhe mënyrën e llogaritjes së tij (këshillën juridike”)*. Në këtë kuptim gjykata vlerëson se, vendimi kontestues i organit te paditur nuk përmban elementet e aktit administrative ashtu siç parashihet me dispozitat ligjore te lartecekuaara, andaj mungesa e këtyre elementeve një akte tille e bënë të pavlefshëm, pasi qe akti kontestues është nxjerrë në kundërshtim me formën e kërkuar nga ky ligj. Arsyetimin i vendimit kontestues është jashtë objektit kontestit, për arsye se ne dispozitiv të vendimit kontestues është theksuar se është refuzuar ankesa për caktimin e taksës vjetore për ushtrim te veprimtarisë, ndërsa ne arsyet e te njëjtit vendim është theksuar se ankuesi është ngarkuar me takse vjetore për vendosjen e antenave. Andaj duke marre parasysh konstatimet e lartecekura kolegji vlerëson se vendimi i kontestuar nuk përmban një vlerësim të fakteve në raport me dispozitat ligjore, andaj një vendim i tille nuk mund të quhet se është i drejtë dhe i ligjshëm dhe se është marr me respektimin e dispozitave ligjore të Ligjit për Procedurën Administrative. Gjykata vlerëson se e paditura nuk i është përgjigjur bazës se ankese se paditësit, duke trajtuar çështjen jashtë objektit te kontestit.

Ndërsa lidhur me pretendimet ne ankesën e ankuesit se autoriteti kompetent për dhënien e lejeve për vendosjen / ndërtimin e antenave është ministria e Mjedisit dhe jo komunat, kolegji i ka pranuar si te arsyeshme pretendimet e tilla dhe këto pretendime i ka shqyrtuar ne vështrim

te nenit LIGJI Nr. 04/L-110 për ndërtim neni 19 parasheh se “Kompetencat për lëshimin e lejes ndërtimore 1. Ministria ka kompetencë për lëshimin e lejeve për ndërtimet e kategorisë III, sipas Shtojcës nr. 1 të këtij ligji. 2. Komunitet lëshojnë leje ndërtimore për kategoritë I dhe II të ndërtimeve. Ndërsa sipas Shtojcës nr. 1 të këtij ligji 1.16. objektet e telekomunikacionit, përkatësisht rrjetit, sistemet ose pajisjet të cilat janë të rëndësishme ndërkombëtare dhe magjistralet si dhe ato të cilat ndërtohen në territorin e dy apo më shumë komunave”. Gjykata ka shqyrtuar ligjshmërinë e vendimit kontestues dhe vlerëson se ne pjesën me të madhe të vendimit kontestues i referohen vendimeve të tyre të mëhershme të cilat ishin atakuar në gjykate themelore, e me të cilat vendim nr. 02/nr. 78345/2012 dt.12.12.2012 ishte qene objekt i shqyrtimit të ligjshmërisë në gjykata të Kosovës ku ne arsyetimin këtij ishte theksuar “se taksat për antena nuk kanë të bëjnë me ushtrimin e veprimtarisë, por me taksën në pronën e paluajtshme”. Andaj kolegji vlerëson se janë të paqëndrueshme dhe të paqarta arsyetimet e vendimit kontestues kur në njërin anë deklaron se taksa ka të bëjë me ushtrimin e veprimtarisë ndërsa në anën tjetër për lejimin e vendosjes së antenave në territorin e komunës duke marrë si reference vendimet paraprake se ka të bëjë me tatimin në pronën e paluajtshme. Në bazë të certifikatës së ARBK paditësi ka dëshmuar se nuk ushtron veprimtari afariste në komunën e Hanit të Elezit. Prandaj kolegji vlerëson se vendosja e taksa për dhënie e pëlqimit për vendosjen e antenave në vlerat nga 500 € konsiderohet tatim në pronën ku janë vendosur këto antena. Andaj kolegji konsideron se pavarësisht emërimit se si është përshkruar taks apo tatim, qëllimi i kësaj takse trajtohet si takse për pagesën në pronën ku janë vendos antenat e paditësit.

Kolegji i kësaj gjykate pas analizimit dhe vlerësimit të provave materiale të cilat janë administruar nga gjykata e shkallës së parë, në raport me dispozitat ligjore të aplikueshme në rastin konkret pranon si të bazuara në ligj kërkesëpadinë e paditësit pasi që në bazë të nenit 22 paragraf 6 të Ligjit 04/L-109 për Komunikim Elektronike parasheh se: „Ndërtimi i rrjetave publike të komunikimeve elektronike si dhe faciliteteve shoqëruese është në interesin publik. Taksa e pronës së paluajtshme nuk zbatohet për rrjetat e komunikimeve elektronike dhe faciliteteve shoqëruese, duke përfshirë edhe ato për rrjetat mobile (GSM), stacionet bazë, satelitët dhe infrastruktura nëntokësore. Ndërsa në përkufizimet e ligjeve parashihet se me facilitetet nënkuptojmë shërbime të lidhura, infrastruktura fizike dhe objektet tjera ose elementet që lidhen me një rrjet dhe ose me një shërbim të komunikimeve elektronike të cilat mundësojnë dhe ose mbështesin ofrimin e shërbimeve nëpërmjet këtij rrjeti dhe ose shërbimi ose që kanë potencialin për ta bërë këtë dhe përfshijnë, ndër të tjera, edhe ndërtesat apo hyrjen në ndërtesa, kabllo të ndërtesave, antenat, kullat dhe konstruksionet tjera mbështetëse, kanalet, përçuesit, shtyllat, pusetat, dhe kabinetet. Andaj në interpretimin e drejtë të këtyre dispozitave ligjore kuptohet se taksa e pronës së paluajtshme nuk zbatohet për rrjetat e komunikimit publik, dhe këto rrjete janë të liruara nga pagesat e tatimit në pronë. Në situatën e njëjte juridike Gjykata Kushtetuese e Kosovës me Aktgjykim në rastin nr. KI 189/20 Parashtrues IPKO Telecommunications L.L.C. Prishtinë, me 11 nëntor 2021 Nr. ref. AGJ 1889/21 Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit ARJ-UZPV. nr.17/2020, të 20 janarit 2020, e cilin aktvendim ishin gjetë shkelje të nenit 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës lidhur me paragrafin 1 të nenit 6 të Konventës Evropiane për të drejtat e njeriut (e drejta për

një proces të rregullt) dhe është vërtetuar se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme është i pavlefshëm dhe i është kthyer të njëjtës në rishqyrtim. Mbi bazën e të cilit vendim Gjykata Supreme e Kosovës me Aktgjykimin UZVP-ARJ.br.127/2021 të datës 25.11.2021, ka aprovuar si të bazuar kërkesën e paditësit për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor dhe ka prish aktgjykimin e Gjykatës së Apelit AA.nr.585/2018 të dt.01.11.2019 dhe lënda i është kthyer kësaj gjykate në rishqyrtim dhe rivendosje. Te cilin ne ri procedurë gjykata e apelit me aktgjykimin nr. AA.nr.30/2022, refuzohet si e pa bazuar ankesa e të paditurës Komuna e Gjakovës, e datës 19.10.2018, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.2105/2014, të datës 06.09.2018, Vërtetohet, me të cilin aktgjykim te gjykatës themelore ishte aprovuar paditësi dhe është liruar paditësi nga taksa-tatimi për pagesën e vendosjes se antenave.

Kolegji vlerëson se në rrethanat e rastit konkret Ligji për Komunikime Elektronike është Lex Speciale në krahasim me ligjet tjerë. Gjykata ka vlerësuar bazën ligjore që ka të bëjë me statusin e objektit të kontestit edhe nga dispozita e nenit 22 paragrafi 6 të Ligjit nr. 04/L-109 për komunikimet elektronike, ku ka konstatuar se taksa e pronës së paluajtshme nuk zbatohet për objektin-antena satelitore pronë e paditësit. Andaj gjykata e obligonë Komunën e Hanit të Elzit që paditësin Ipko Telecommunications LLC me seli në Prishtinë të liroj nga borxhi i tatimit në pronë për periudhën 2018 përfshirë kamatën dhe ndëshkimet e cila periudhe është objekt shqyrtimi i këtij konflikti administrative

Bazuar në të sipërcekurat dhe nga fakti se në shkresat e lëndës ka prova të mjaftueshme për vërtetimin e plotë të gjendjes faktike, kolegji vlerëson se gjykata e shkallës së parë mbi gjendjen faktike gabimisht e ka zbatuar të drejtën materiale kur ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar, andaj është dashtë që aktgjykimi i atakuar të ndryshohet dhe të aprovohet kërkesëpadia e paditësit.

Gjykata ka vendosur sikurse në pikën IV (katër) të këtij aktgjykimi, pasi që pika III (tre) e aktgjykimit të ankimuar, nuk kanë qenë objekt ankimimit.

Nga të cekurat konform Nenit 195.1 pika e) e LPK-së u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË
Dhoma e Shkallës së Dytë
K.DH.SH.II.nr.980/22, me datë 21.06.2023

KRYETAR I KOLEGJIT, GJYQTARI
RAMUSH BARDIQI